

Bazuar në Nenin 35, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 Gusht 2010) dhe nenet 18 dhe 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 11/11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2012, miratoi si vijon:

## **RREGULLORJA PËR NDRYSHIMET NË LLOGARITË E KAPITALIT**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të specifikojë llojet e transaksioneve që ndikojnë në kapitalin e bankës, të cilat kërkojnë aprovimin e BQK-së, mirëpo asnjë transaksion nuk do të aprovohet nëse rezulton me zvogëlimin e kapitalit të paguar të bankës nën nivelin minimal të kërkuar me Nenin 15 të Ligjit për Bankat.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje aplikohen për të gjitha bankat e licencuara nga BQK për të operuar në Republikën e Kosovës, me përjashtim të degëve të bankave të huaja.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

Të gjitha termet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përkufizuara në Nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-093 mbi bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: *Ligji për Bankat*) ose / dhe siç përkufizohen me poshtë për qëllimin e kësaj rregullore:

- a) *Bankë* - do të thotë një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur, të licencuar nga BQK-ja.
- b) *Dege e bankës së huaj* - do të thotë një person që është i organizuar, ka selinë e vet dhe posedon licence për tu angazhuar në veprimtari bankare në ndonjë juridiksion tjetër përveç Kosovës.

### **Neni 3**

#### **Transaksionet që kërkojnë aprovim paraprak nga BQK-ja.**

1. BQK-ja duhet të shqyrtoj dhe aprovoj ndryshimet e caktuara në llogaritë e kapitalit të bankës, para se ato të bëhen. Banka, së pari duhet të kërkoj dhe pranoj aprovimin e BQK-së për këto ndryshime, pastaj lajmëron BQK-në kur është bërë ndryshimi dhe se ai ndryshim është në përputhje me kërkesat rregullatore. Pas pranimit të njoftimit, BQK-ja vërteton dhe autorizon ndryshimin, sipas rastit, me kusht që është në pajtueshmëri me rregulloret e aplikueshme. Ndryshimi është efektiv me vërtetimin apo autorizimin e BQK-së. Këto ndryshime përfshijnë:

- a) Shitjen e kapitalit aksionar, përveç shitjes me para të gatshme;
- b) Zvogëlimin e kapitalit aksionar përmes shpërndarjes së parave të gatshme ose mjeteve;
- c) Pagesës së aksioneve përmes dividendës;
- d) Pronësinë e dividendave (dividenta jo në para të gatshme);

2. Asnjë transaksion nuk do të aprovohet, i cili mund të rezultojë në atë që kapitali i paguar i bankës nuk do përmbushte nivelin minimal të kërkuar nga Neni 15 të Ligjit për Bankat.

#### **Neni 4**

##### **Ndryshimet që kërkojnë vetëm certifikimin apo autorizimin e BQK-së**

1. BQK-ja do të aprovoj ndryshime të caktuara në kapital, me kusht që ato ndryshime janë në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore. Këto ndryshime nuk kërkojnë aprovim paraprak nga BQK-ja. Banka duhet të njoftoj BQK-në për ndryshimin dhe të vërtetoj se është në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore. Nëse e lajmëron, BQK-ja vërteton apo autorizon ndryshimin pas marrjes së lajmërimit, duke e bërë atë efektiv. Këto ndryshime përfshijnë:

- a) Shitjen e kapitalit aksionar për para të gatshme.
- b) Ristrukturimi për të ndryshuar vlerën nominale të aksioneve të kapitalit, ku ndryshimi në llogarinë e kapitalit aksionar është barazuar me ndryshimin në llogarinë e rezervës së kapitalit aksionar.

#### **Neni 5**

##### **Ndryshimet që nuk kërkojnë aprovimin, vërtetimin apo autorizimin nga BQK-ja**

1. Ndryshime të veçanta në kapital, nuk kërkojnë aprovim nga BQK-ja, megjithatë mund t'i nënshtrohen kërkesave tjera rregullatore. Këto ndryshime janë efektive me aprovimin e aksionareve për ndryshim dhe lajmërimin e BQK-së për ndryshim dhe përfshijnë:

- a) Ndryshimi në shumën e autorizuar, por të pa emetuar të kapitalit aksionar.
- b) Ndarja e aksioneve që nuk ndryshon shumën në llogarinë e kapitalit aksionar.

#### **Neni 6**

##### **Politikat e përgjithshme**

1. BQK-ja do të aprovoj ndryshimet në kapital, që përputhen me rregulloret e aplikueshme, me marrjen e informacioneve të kërkuara nga bankat. Këto informacione jepen si lajmërim paraprak për llojin dhe shumën e ndryshimit të propozuar. Për bankat në kushte të kënaqshme, aprovimi në përgjithësi do të jepet përveç nëse struktura e propozuar e kapitalit nuk konsiderohet adekuate sipas rregulloreve, udhëzimeve apo politikave të BQK-së. Për bankat në kushte jo të kënaqshme, ndryshimi në kapital mund të refuzohet ose të aprovohet me kusht, me zgjedhje të BQK-së për arsye të sigurisë dhe shëndetit financiar të bankës, apo ndonjë shqetësimi tjetër mbikëqyrës. Veçanërisht, aprovimi i ndryshimit në kapital mund të ndalohet për bankat që:

- a) Dështojnë të jenë në pajtueshmëri me planin e kapitalit të dorëzuar në BQK.
- b) Propozojnë strukturë të kapitalit, që BQK-ja e konsideron të jetë joadekuate.
- c) Nuk janë në pajtueshmëri me rregulloret .
- d) Shfaqin kushte që kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin financiar.
- e) Dështojnë të ofrojnë informacione adekuate.

## **Neni 7**

### **Kërkesat për ndryshime të veçanta në kapitalin aksionar**

#### **1. Shitja e kapitalit aksionar për para të gatshme**

Aksionarët duhet të aprovojnë çfarëdo rritje në kapitalin aksionar të autorizuar por jo të emetuar, në pajtueshmëri me kërkesat Nenit 24 të Ligjit për Banka dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Në shitjen e aksioneve, banka duhet të lajmëroj BQK-në dhe të vërtetoj se ndryshimi në kapital aksionar i plotëson kërkesat rregullatore. Me marrjen e lajmërimit, BQK-ja vërteton rritjen në kapitalin aksionar, me kusht që kjo rritje është në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore.

#### **2. Shitja e kapitalit aksionar për pronë**

Aksionarët duhet të aprovojnë çfarëdo rritje të nevojshme në kapitalin aksionar të autorizuar por jo të emetuar, në pajtueshmëri me kërkesat e Nenit 24 të Ligjit për Banka dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Banka duhet të dorëzoj në BQK një letër qëllimi për të ndryshuar kapitalin aksionar dhe të marr aprovimin nga BQK-ja para se të bëj ndryshimin. Informata të mjaftueshme lidhur me transaksionin dhe siç specifikohet nga BQK-ja, duhet t'i ofrohet BQK-së për vlerësim dhe analiza të transaksionit të propozuar. Pas aprovimit të transaksionit të propozuar nga BQK-ja dhe pas shitjes së aksioneve, banka duhet të njoftoj BQK-në dhe të vërtetoj se ndryshimi në kapitalin aksionar plotëson kërkesat rregullatore. Me marrjen e lajmërimit, BQK-ja do të vërtetoj rritjen në kapital aksionar, me kusht që plotëson kërkesat rregullatore.

#### **3. Zvogëlimi në kapitalin aksionar apo rezerva duke shpërndarë para të gatshme apo mjete**

Aksionaret duhet të aprovojnë çdo zvogëlim në kapital aksionar, në pajtueshmëri me kërkesat e Nenit 24 të Ligjit për Bankat dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Aksionarët, gjithashtu duhet të aprovojnë çdo shpërndarje që ka të bëjë me para të gatshme apo mjete. Banka duhet të dorëzoj në BQK një letër qëllimi për të ndryshuar kapitalin aksionar dhe të marr aprovimin para se të zvogëloj kapitalin aksionar ose rezervën e kapitalit aksionar. Pas përfundimit të zvogëlimit, banka duhet të njoftoj BQK-në dhe të vërtetoj se ndryshimi në kapitalin aksionar i plotëson kërkesat rregullatore. Pas marrjes së njoftimit, BQK-ja autorizon zvogëlimin në kapitalin aksionar, me kusht që ajo i plotëson kërkesat rregullatore.

#### **4. Zvogëlimi në kapitalin aksionar me transfer në rezerva**

- a) *Transferet nga "rezervat e tepërta"* - Një bankë mund të transferoj rezervat e tepërta nga rezervat në fitime, në dispozicion për pagimin e dividendëve. Banka mund të transferoj tepërcën, vetëm nëse ajo është e fituar, p.sh nëse tepërcia rrjedh nga të ardhurat e periudhave të mëparshme dhe jo nga rezervat e kapitalit aksionar të paguar ose transfereve për të regjistruar një dividendë të aksioneve.
- b) Aprovimi i aksionarëve nuk kërkohet për ndryshimin nga nën-paragrafi a).i këtij paragrafi por Bordi Drejtues i bankës duhet ta aprovoj transferin. Banka duhet të dorëzoj në BQK një letër qëllimi dhe të pranoj paraprakisht aprovimin, për të bërë ndryshimin.

## **5. Dividentët jo në para të gatshme**

Një Bankë mund të deklaroj dividendat të pagueshme në pronë, me aprovim të BQK-së. Para se të deklarohet dividendat, prona duhet të vlerësohet për të pasqyruar vlerën aktuale të saj të tregut. Çdo vlerësim i pronës duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave nëse prona është vënë në dispozicion për shitje. Dividentat duhet të regjistrohet në shumën, e barabartë me vlerën aktuale të pronës. Banka duhet të kërkoj dhe pranoj aprovimin e BQK-së, para pagesës së dividendës.

## **6. Dividentat që kërkojnë aprovim**

Aprovimi i BQK-së kërkohet edhe në qoftë se totali i të gjitha dividendave të deklaruara nga banka në çfarëdo viti kalendarik i tejkalon fitimet neto të atij viti plus fitimet neto të mbajtura të dy viteve të kaluara, minus transferet e kërkuara për rezerva. Banka duhet të kërkoj dhe pranoj aprovimin e BQK-së, para pagesës së dividendës.

## **7. Ndarja e aksioneve**

- a) Ndarja e aksioneve, në mënyrë tipike rrit numrin e aksioneve aktive dhe zvogëlon çmimin e tregut për secilin aksion. Ndarja e zakonshme e aksioneve përfshin zvogëlimin e vlerës nominale të aksioneve, ndërsa rrit numrin e aksioneve të emetuara. Për shembull, 100,000 aksione me vlerë nominale dhjetë (10) euro për aksion, mund të ndahen në 2 për 1, e cila do të rezultojë në 200,000 aksione me vlerë nominale pesë (5) për aksion. Aksionarët duhet të aprovojnë plotësimin (ndryshimin) në statutin e bankës, për të ndryshuar vlerën nominale të aksioneve. Nuk kërkohet aprovim nga ana e BQK-së, derisa shumat në llogaritë e kapitalit nuk ndryshojnë.
- b) Ndarja e aksioneve mund të ndikohet edhe me deklarimin e dividendave në aksione. Dividentat në aksione, të cilat tejkalojnë njëzet për qind (20%) të aksioneve të emetuara, klasifikohen si ndarje të aksioneve dhe llogariten duke transferuar në kapitalin aksionar një shumë jo më të vogël se vlera nominale e aksioneve shtesë të emetuara. Këto dividendat konsiderohen si rikonstruksion i llogarive të kapitalit bazuar në parimet e pranueshme të kontabilitetit dhe nuk janë subjekt i kufizimeve. Aksionarët duhet të aprovojnë çdo rritje në aksionet e autorizuara, por të pa emetuara, në pajtueshmëri me Nenin 24 të Ligjit për Banka dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Pas pagesës së dividendës, banka duhet të njoftoj BQK-në dhe të vërtetoj se ndryshimi i plotëson kërkesat rregullative. Pas marrjes së njoftimit, BQK-ja vërteton rritjen në kapitalin aksionar, me kusht që ajo i plotëson kërkesat rregullative.

## **8. Ndryshimi në ndarjen e aksioneve**

BQK-ja nuk e lejon ndryshimin në ndarjen e aksioneve që ka si efekt eliminimin e aksionarëve të vegjël.

## 9. Dividentat në aksione

- a) Dividentat në aksion është një emetim i aksioneve që evidenton aksionet e tanishme të pronarit të të ardhurave të akumuluar. Dividentat në aksione llogariten duke transferuar një shumë të barabartë me vlerën e drejtë/fer të aksioneve shtesë të emetuara nga fitimet e pashpërndara në një kategori të kapitalit të përhershëm (kapitali dhe rezervat). Shuma e transferuar nga fitimet pashpërndara nuk do të jetë më e vogël se vlera nominale e aksioneve shtesë të emetuara.
- b) Aksionarët duhet të aprovojnë çdo rritje të nevojshme në aksionet e autorizuara por të pa emetuara, në pajtueshmëri me kërkesat e Nenit 24 të Ligjit për Banka dhe dispozitat relevante të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Pas pagesës së dividendës, banka duhet të njoftojë BQK-në dhe të vërtetojë se ndryshimi i plotëson kërkesat rregullative. Pas marrjes së njoftimit, BQK-ja vërteton rritjen në kapital, me kusht që plotëson kërkesat rregullatore.

## 10. Ndryshimet në vlerën nominale të kapitalit aksionar

Aksionarët duhet të aprovojnë plotësimet në statutin e bankës, për të ndryshuar vlerën nominale të kapitalit aksionar, në pajtueshmëri me kërkesat e Nenit 24 të Ligjit për Banka dhe dispozitat relevante të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Aksionarët gjithashtu duhet të aprovojnë çdo reduktim në kapitalin aksionar. Ndryshimet që përbejnë saktësisht ristrukturim të brendshëm të kapitalit, nuk kërkojnë aprovimin paraprak të BQK-së. (Një ristrukturim i brendshëm i kapitalit do të thotë ndryshimet në vlerën nominale të kapitalit aksionar kur ndryshimi në llogarinë e kapitalit aksionar barazohet me ndryshim të barabartë në rezervat e kapitalit aksionar). Pas përfundimit të ndryshimit, banka duhet të njoftojë BQK-në dhe të vërtetojë se ndryshimi i plotëson kërkesat rregullative. Pas marrjes së njoftimit, BQK-ja vërteton ndryshimin, nëse ajo rezulton në një rritje në llogarinë e kapitalit aksionar, apo autorizon ndryshimin nëse rezulton me rënie në llogarinë e kapitalit aksionar dhe kjo rënie i plotëson kërkesat rregullative.

### Neni 8

#### Procedurat për kërkesat e lartëshënuara

1. Për ndryshimet që kërkojnë aprovimin paraprak nga BQK-ja, banka duhet të dorëzojë një letër qëllimi për të ndryshuar kapitalin aksionar. Letra përshkruan ndryshimin e propozuar në kapital dhe shpjegon arsyen për të. BQK-ja do të shqyrtojë ndryshimin për të përcaktuar se:

- a) Është në përputhje me kushtet e çfarëdo marrëveshje mbi mjaftueshmërinë e kapitalit
- b) Çështjet e propozuara mund të konsiderohen si kapital sipas definicioneve të adaptuara nga BQK.
- c) Ndryshimi është në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet dhe interesat mbikëqyrëse.

2. Një bankë mund të marrë në konsideratë ndryshimin e propozuar si të aprovuar, 30 ditë pasi që BQK-ja pranon letrën e qëllimit, përveç nëse është njoftuar nga ana e BQK-së, se aprovimi është vonuar, kushtëzuar apo refuzuar. Nëse pajtohet me ndryshimin, BQK-ja do të aprovojë transaksionin dhe do të këshillojë aplikuesin për çdo hap shtesë, duke përfshirë një letër të njoftimit, të nevojshme për të kryer ndryshimin.

3. Pas përfundimit të ndonjë ndryshimi të kapitalit, që kërkon vërtetimin apo autorizimin e BQK-së, banka duhet të njoftojë me letër BQK-në, se ndryshimi është bërë dhe se ajo është në pajtueshmëri me kërkesat rregullative. Një bankë mund të marr në konsideratë ndryshimin si të vërtetuar apo autorizuar, 30 ditë pasi që BQK-ja merr njoftimin, përveç nëse ndryshe këshillohet. BQK-ja do të vërtetojë apo autorizoj këto ndryshime në kapital pas marrjes së letrës, me kusht që ndryshimet përmbushin kërkesat rregullative.

4. Ndryshimet e aprovuara në kapitalin aksionar duhet të përfundojnë brenda një viti nga data e aprovimit preliminar.

#### **Neni 9**

#### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Çdo shkelje e kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave korigjuese dhe dënimeve, të përcaktuara në Nenet 58, 59 dhe 82 të Ligjit për Banka.

#### **Neni 10**

#### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregulla XXI e BQK-së mbi Rritjen e Minimumit të Kapitalit të Bankave, ndryshuar me 25 qershor 2004 dhe nëntor 2005 dhe Rregulla XXII e BQK-së mbi Ndryshimet në Llogaritë e Kapitalit të Bankës e adoptuar me 28 mars 2002, dhe çdo provizion tjetër që është në kundërshtim me këtë rregullore.

#### **Neni 11**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi me 03 dhjetor 2012.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Sejdi Rexhepi